

Transporti publik dhe kopshtet si parakusht për zhvillim të hovshëm të vendit



Transporti publik dhe kopshtet si parakusht për zhvillim të hovshëm të vendit

Prishtinë, tetor 2025.

Punim i përgatitur nga:

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D)

Të drejtat e autorit © 2025. **Demokrati për zhvillim (D4D).**

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pasazheve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Ky punim është zhvilluar me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor" të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokrati dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA).

Përmbajtja e këtij punimi është përgjegjësi e vetme e zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA).

Përmbajtja

Përmbledhje	6
Hyrje	9
Dy rekomandimet kryesore	10
1. Qasje më e mirë në arsim dhe zhvillim të hershëm të fëmijëve	10
2. Transporti si hallkë kyçe	11
Dokumenti kryesor për politikë publike	13
Demografia 2011-2024	13
Lindshmëria dhe shkollat	16
Papunësia dhe fuqia punëtore joaktive	17
Rekomandime specifike dhe Plan veprimi	27

Përmbledhje

Kosova po përballlet me një sfidë të dyfishtë që ndërlidhet mes vete: **shpopullimin e fshatrave** dhe **mospërfshirjen e grave në tregun e punës**. Në 10 vitet e fundit, vendi ka humbur rreth 150 mijë banorë (–9%), ku popullsia rurale ka rënë me 36% (290 mijë persona), ndërsa ajo urbane është rritur me 17%. Për herë të parë, më shumë se gjysma e qytetarëve jetojnë në zona urbane. Ky trend shpërnguljeje nuk është i qëndrueshëm dhe shpesh është i nxitur jo nga zgjedhja, por nga mungesa e shërbimeve bazike në fshat.

Në këtë dokument, **Grupi i Grave Lobuese, me mbështetjen e D4D**, propozon dy ndërhyrje kyçe, me efekt të menjëhershëm dhe të qëndrueshëm:

Sfida #1: Mungesa e kopshteve publike në fshatra –

Kujdesi dhe zhvillimi i hershëm i fëmijëve është vendimtar për suksesin e tyre në jetë. Sot, vetëm një pjesë e vogël e fëmijëve ndjekin kopsht, kryesisht në familjet urbane me dy prindër të punësuar. Kjo krijon pabarazi të thellë sociale dhe e mban barrën e kujdesit mbi gratë, duke i përjashtuar ato nga tregu i punës. Rekomandohet hapja e çerdheve rurale të integruara në rrjetin publik të arsimit, me planprogram bashkëkohor, si prioritet kombëtar.

Sfida #2: Transporti publik i subvencionuar –

Mungesa ose kostoja e lartë e transportit është një pengesë madhore për gratë dhe familjet rurale në qasje në punë, arsim dhe shërbime shëndetësore. Rekomandohet subvencionimi i linjave të transportit rural për të siguruar lidhje të rregullta dhe të përballueshme mes fshatrave dhe qendrave urbane.

Te këto dy përfundime kemi arritur me 4 studime, raste studimore të 3 fshatrave në Kosovë nga tri zona të ndryshme dhe të studimit të të dhënave në nivel vendi, kryesisht bazuar në të dhënat e regjistrit të fundit të popullatës. Të tri fshatrat, ashtu si edhe të dhënat e regjistrimit të popullatës dëshmojnë se ka **trend të madh të shpërnguljes**. Rënia e numrit të banorëve e bën gjithnjë e më pak të levërdishme përmirësimin e shërbimeve. Sa më pak banorë që mbesin, më vështirë është të binden deputetët dhe këshilltarët komunal që të ndajnë buxhetin e duhur. Ky cikës vicioz tutje nxit shpërnguljen dhe shumë fshatra vetëm se kanë rënë nën një masë kritike që e katandis fshatin drejt braktisjes së tërësishme.

Nëse realizohen këto dy intervenime, mund të priten disa përfitime të ndjeshme:

Përfitimi #1:

Rritja e punësimit të grave dhe zvogëlimi i varësisë nga skemat sociale.

Përfitimi #2:

Ulja e shpërnguljes dhe gjallërimi i fshatrave.

Përfitimi #3:

Rritja e të ardhurave familjare dhe zhvillimi ekonomik lokal.

Përfitimi #4:

Përfitime afatgjata për ekonominë kombëtare: çdo 1 € i investuar në kujdesin e hershëm gjeneron deri në 7–10 € kthim.

Për këtë qëllim, **Qeveria që do të formohet, me mbështetje bipartizane të tërë spektrit politik**, të shpallë kopshtet dhe transportin publik rural si prioritet nacional dhe të dedikojë fonde të veçanta në buxhet.

Komunat ta përfshijnë këtë agjendë në programet zgjedhore dhe buxhetet lokale për vitet në vijim, duke e bërë pjesë të zotimeve publike për zgjedhjet e ardhshme.

Shoqëria civile të vazhdojë avokimin, monitorimin e zotimeve dhe mobilizimin e komuniteteve për të kërkuar shërbime të barabarta.

Ky dokument nuk ofron vetëm një **zgjidhje sociale**, por një **strategji zhvillimore** për të ardhmen e Kosovës – një vizion ku fshatrat nuk braktisen, ku gratë kontribuojnë barabartë në ekonomi dhe ku shërbimet publike janë të qasshme për të gjithë qytetarët, kudo që jetojnë.

Hyrje

Kosova sot përballet me një nga sfidat më të mëdha shoqërore dhe ekonomike: **shpopullimin e fshatrave dhe përjashtimin e grave nga tregu i punës**. Në dekadën e fundit, vendi ka humbur afro 150 mijë banorë, ku goditja më e rëndë është ndjerë në zonat rurale, të cilat kanë humbur mbi një të tretën e popullsisë së tyre. Ky trend i shpërnguljes, i ushqyer nga mungesa e shërbimeve bazike, rrezikon të shndërrojë shumë fshatra në hapësira të braktisura dhe të humbura përfundimisht.

Në thelb të këtij problemi janë dy boshllëqe madhore: **mungesa e çerdheve publike për fëmijët dhe mungesa e transportit publik të qasshëm e të përballueshëm për komunitetet rurale**. Kur nuk ka çerdhe, fëmijët humbin fazën më të rëndësishme të zhvillimit të tyre, ndërsa gratë (74%) mbesin të ngujuara në shtëpi, pa pasur mundësi të zhvillojnë karrierë apo të kontribuojnë në ekonomi. Kur nuk ka transport, qasja në punë, arsim dhe shërbime bëhet e paarrtshme dhe familjet detyrohen të braktisin fshatrat.

Ky dokument, i hartuar nga **Grupi i Grave Lobuese me mbështetjen e D4D**, ofron një **platformë konkrete rekomandimesh për qeverinë qendrore, komunat dhe shoqërinë civile**. Ai bazohet në të dhëna nga regjistrimi i fundit i popullsisë, hulumtimet e D4D dhe mikro-studimet në tri fshatra nga zona të ndryshme të vendit. Qëllimi është i qartë: **të ndalim shpërnguljen, të fuqizojmë gratë dhe të nxisim zhvillim të qëndrueshëm**.

Përfitimet janë të shumta dhe të matshme. Studimet ndërkombëtare tregojnë se për çdo 1 euro të investuar në kujdesin e hershëm për fëmijët, kthehen deri në 7–10 euro

përfitime afatgjata ekonomike. Po ashtu, subvencionimi i transportit publik nuk është vetëm lehtësim për qytetarët, por një hap drejt një ekonomie më të fuqishme dhe një shoqërie më të barabartë.

Në këtë kontekst, ky dokument nuk është thjesht një thirrje për masa sociale – është një **plan zhvillimi kombëtar** që mund të ndryshojë drejtimin e Kosovës, duke i dhënë jetë të re fshatrave dhe duke krijuar një ekonomi ku gratë dhe burrat kontribuojnë në mënyrë të barabartë.

Dy rekomandimet kryesore

1. Qasje më e mirë në arsim dhe zhvillim të hershëm të fëmijëve

Zhvillimi i hershëm i fëmijëve është vendimtar për suksesin e tyre në sistemin arsimor dhe më tej në jetë. Në mungesë të çerdheve në zonat rurale, fëmijët humbasin fazën më të rëndësishme të përvetësimit të aftësive themelore si gjuha, shoqërizimi dhe aftësitë kognitive. Duke hapur çerdhe në fshatra dhe duke i integruar ato në rrjetin publik të arsimit parashkollor, do të sigurohet **barazi në mundësi për të gjithë fëmijët**. Në Kosovë, një numër shumë i vogël shkojnë në kopsht, dhe atë kryesisht fëmijët e familjeve me dy të punësuar në zona urbane. Ky diskriminim thellon dallimet duke diskriminuar të varfërit dhe banorët e zonave rurale. Kur kujdesi për fëmijët bie kryesisht mbi gratë, kjo **nuk i inkurajon që të zhvillojnë karrierë dhe mbesin jashtë tregut të punës**.

Kërkesa #1: Hapja e kopshteve të reja me planprogram bashkëkohor mësimor duhet të jetë prioritet nacional

ashtu që të gjithë fëmijët të kenë mundësi më të mëdha për sukses.

2. Transporti si hallkë kyçe

Subvencionimi i transportit publik për gratë dhe punëtorët në zonat rurale do të **zvogëlonte barrën financiare** dhe do të mundësonte **qasjen në punë, edukim dhe shërbime**. Aktualisht, mungesa ose kostoja e lartë e transportit është një pengesë serioze për shumë gra që do të dëshironin të punonin apo të ndiqnin trajnimet profesionale. **Familjet ikin për shkak të mundësive për punë, shëndetësi dhe arsim**. Ngarendja drejt qyteteve, veçanërisht drejt Prishtinës jo gjithmonë sjell përmirësim të jetesës, duke ditur se ballafaqohen me probleme të shumta siç është mungesa e ujit për banorët e saj të tanishëm. Në vend se të sakrifikojnë cilësinë e jetesës për një shpresë afatgjate, transporti publik më cilësor do të mundësonte banorëve të fshatrave të shfrytëzojnë të gjitha epërsitë që sjell qyteti pa qenë të detyruar të zhvendosen.

Kërkesa #2: Transporti publik duhet të subvencionohet ashtu që fshatrat e vogla të kenë qasje tek shërbimet publike cilësore qoftë në qytet apo në fshatra më të mëdha.

Me çerdhe funksionale në afërsi dhe **transport të subvencionuar**, gratë kanë mundësi reale të **angazhohen në ekonomi**, të zhvillojnë karrierën dhe të kontribuojnë në të ardhurat familjare. Ka studime të shumta që janë përqendruar në punësimin e grave, qoftë nga Banka Botërore apo Instituti GAP dhe më herët edhe nga D4D t'ju vendosen hiperlinkat studimeve të përmendura. Rritja e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore sjell **rritje të të ardhurave kombëtare** përmes tatimeve, konsumit dhe kontributit në sistemin

pensional. Studimet ndërkombëtare tregojnë se për çdo euro të investuar në kujdesin e hershëm për fëmijët, kthehen deri në 7-10 euro në formë të përfitimeve ekonomike afatgjata. Në Kosovë, ku norma e pjesëmarrjes së grave në punë është ndër më të ulëtat në Evropë, këto masa do të kishin **efekt të menjëhershëm në rritjen e produktivitetit ekonomik dhe zvogëlimin e varfërisë** në familjet rurale. Për më tepër, do të zvogëlonte varësinë nga skemat sociale dhe do të rriste vetëbesimin dhe pavarësinë ekonomike të grave.

Hapja e çerdheve në zonat rurale dhe subvencionimi i transportit publik për gratë dhe familjet me të ardhura të ulëta nuk është vetëm një masë sociale, por një **investim strategjik për zhvillimin afatgjatë të Kosovës**. Këto masa përmirësojnë ndjeshëm qasjen në arsim, fuqizojnë gratë dhe sjellin përfitime të drejtpërdrejta ekonomike për vendin. Prandaj, ato duhet të përfshihen në prioritetet e politikave publike, pasi përfitimet e tyre tejkalojnë shpenzimet fillestare dhe krijojnë një shoqëri më të barabartë, më të zhvilluar dhe më të qëndrueshme ekonomikisht.

Dokumenti kryesor për politikë publike

Platforma më lartë mbështetet nga hulumtimi më poshtë i cili është analizë e disa shifrave të regjistrit të popullsisë nga ASK, omnibusit të realizuar nga D4D dhe të gjeturave nga mikro-studimet e 3 fshatrave si dhe disa të gjeturave nga burime tjera.

Demografia 2011-2024

Në regjistrimin e fundit të popullatës, Kosova del se ka afër 1,6 mln banorë, rreth 150 mijë (9%) më pak se 10 vite më parë. Efekti më drastik ka qenë tek popullata rurale, e cila ka rënë për rreth 290k (36%), përderisa popullata urbane është rritur për 134 mijë (17%).

	2011	2024	Dallimi	%
Popullsia e përgjithshme	1,739,825	1,585,566	(154,259)	-10%
Urbane	661,586	795,627	134,041	17%
Rurale	1,078,239	789,939	(288,300)	-36%
% rurale	62%	50%		

Largimi i qytetarëve nga zonat rurale drejt atyre urbane dhe jashtë vendit është brengosës dhe paraqet sfidë të madhe. Rreth ¼ e banorëve kanë braktisuar fshatin në 13 vitet e fundit, dhe tani për herë të parë popullata urbane është mbi 50%. Kjo lëvizje ka anët pozitive por edhe ato negative nëse ndodh për

shkak të mungesës së shpresës dhe për kërkim të disa shërbimeve bazike.

Shifrat rreth migrimit dhe imigrimit (largimit dhe ardhjes) tutje ndërllojnë analizën. Del se ka largim prej 365 mijë personave, dhe se shifra prej 267 mijë (siç paraqitet më poshtë) apo 288 mijë siç del më lart është e zbutur nga 98 mijë persona të ardhur, që nuk kuptohet profili i tyre nga të dhënat e paraqitura deri tani nga regjistrimi i popullatës.

2012	Imigrimi	97,660
2023	Emigrimi	364,997
Net migrimi		267,337

Përveç shkaktarëve për migrim, ardhja aq e shpejtë në qytete gjithashtu asocohet me mungesë të shërbimeve në qytet. Shërbimet publike në qytete e kanë të vështirë të absorbojnë numër të madh të migrimit dhe mund të përballen me kufizime në ujë, shërbime shëndetësore dhe klasë të stërmbushura në shkolla (si p.sh. në Fushë Kosovë dhe Prishtinë).

	2011	2024	Dallimi
Ndërtesa për banim	340,945	414,273	73,328
Banesa për ndërtesë	1.30	1.41	0.11
Banesa të zbrazëta	99,808	182,849	83,041
Banorë për banesë/shtëpi	4.22	2.85	(1.37)
Dhoma për banesë	4.00	4.06	0.06

Është rritur edhe numri i banesave të zbrazëta për 83 mijë, që një pjesë mund të jenë në qytete por shumica mund të jenë shtëpi që kanë mbetur bosh në fshatra. Nëse popullata rurale është zvogëluar për 288 mijë, del se kanë braktisur afër 70 mijë shtëpi në fshatra duke llogaritur mesataren e banorëve për shtëpi prej 4.2. Ky supozim mund të mos jetë aq i saktë pasi

që nuk ka rënie të ekonomive familjare në fshatra. Si konkludim del se


	2011	2024	Dallimi
Ekonomitë familjare	297,090	366,595	69,505
Persona në familje	5.9	4.3	(1.5)

kanë migruar të rinjtë, personat që kanë banuar së bashku, si dhe çiftet e reja nuk banojnë më me prindërit.

Interesante që edhe pse është zvogëluar numri i banorëve për shtëpi/banesë (tani 2.85) është rritur mesatarja e dhomave për banesë vetëm për 0.06, edhe pse është rritur hapësira mesatare e shfrytëzueshme. Edhe pse madhësitë e banesave janë rritur vetëm për 0.06, hapësira për kokë banori është rritur nga 13.3 në 20.41 që reflekton që jetojnë vetëm familjet e ngushta. Fondi i ndërtesave dhe banesave është rritur jashtëzakonisht shumë duke krijuar komoditet të shtuar. Ndërtesat për banim janë rritur për 22%, përderisa banesat bosh janë rritur për 83%. Numri i banorëve për banesë është më pak se 3. Në fshatra pothuajse askush nuk jeton me qira, por në qytet mbi 10% të banorëve nuk kanë banim të vetin.

Statusi i banimit / Lloji i pronësisë	Lloji i njësisë së banimit				
	Banesa të zakonshme (të shfrytëzuara)				
	Pronar	Me qira	Shfrytëzim i përkohshëm	Njësi tjera banimi	Gjithsej
Urbane	172,648	18,461	4,989	123,861	319,959
Rurale	167,312	854	2,256	102,726	273,148
Gjithsej	339,960	19,315	7,245	226,587	593,107

Grafikoni më poshtë tregon rënien e banorëve nga viti 2011 në 2014 sipas moshës. Ky grafik mundëson për të kuptuar se cilit faktor i duhet atribuar rënia më shumë, migrimit apo natalitetit.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Rënia e numrit të fëmijëve dhe migrimi nga zonat rurale janë përkthyer në familje më të vogla me mesatare prej 4.3 anëtarëve (në zonat urbane nën 4 anëtarë). Por kostoja e ngrohjes dhe shumë shpenzimeve asocohet me banim dhe tani mund të llogaritet se është më e lartë për kokë banori.

Lindshmëria dhe shkollat

Për shkak të rënies së lindshmërisë, ka rënë numri i fëmijëve nën 6 vjeç për 26 mijë. Rritja e cilësisë së jetesës ka rritur edhe numrin e të moshuarve, jo vetëm si përqindje, por edhe si numër absolut për 57 mijë. Ka rënë numri i personave "të mbajtur", d.t.th. që nuk gjenerojnë të ardhura (<14, >65) për rreth 82 mijë, që ofron lehtësim për ekonominë sepse zvogëlohet raporti i personave që një i punësuar duhet të mbajë me të ardhura. Çdo vit rreth 21,500 arrijnë moshën për kopsht.

Të dhënat nga ASK tregojnë që lindshmëria ka arritur kulmin kah fundi i viteve 70a përderisa popullata diku kah fundi i dekadës së parë pas luftës. Nga tabela në të djathtë mund të nxirret numri mesatar për çdo nivel shkollor ($107,000/5 = 21,400$). Nëse kopshtet në Kosovë do të pranonin të gjithë fëmijët, do të duhej të kishin rreth 112 mijë për moshat 0-5. Ngjashëm, për parashkollor do të duhej të ishin minimum 21,206 (sa ishte lindshmëria më 2023). Nga mosha 0-4 janë 107,710 që del se në moshën 0-6 janë 160 mijë, d.t.th. rreth 10% të popullatës.

Papunësia dhe fuqia punëtore joaktive

Në Kosovë, vetëm 26% të grave janë në treg të punës, d.t.th. duke punuar ose duke kërkuar punë, krahasuar me 61% të meshkujve të moshës për punë. Kur flitet për të punësuarat dhe të papunat, janë përqindje brenda shifrës prej 26%. Tre të katërtat e grave as nuk janë të punësuarat dhe as nuk kërkojnë punë. Prandaj në shifra për treg të punës figurojnë mbi 300 mijë meshkuj dhe afër 114 mijë gra, siç tregon grafikoni më poshtë për shkathtësitë e personave në treg të punës.

Transporti publik dhe kujdesi për fëmijët: Çelës për zhvillim, punësim dhe politikë kundër shpërnguljes

Mungesa e:

- Kujdesit për fëmijë dhe të moshuar;
- Transportit publik;
- Shkathësive dhe punëve me pagesë të lartë që arsyeton transport dhe përkujdes privat.

Shkaku

Pasojat për...

Më 2011 në fshat banonin 1.2 milion, sot banojnë 0.8



1/3 e banorëve kanë lënë fshatin për qytet apo jashtë vendit




... vendin

... ekonominë

Nuk plotësohen konkurset në Kosovajob, ku shumica janë në këto profile të përshtatshme:

- Tregti me shumicë dhe pakicë;
- Bujqësi, pylltari dhe peshkim;
- Prodhim;
- Hoteleri dhe gastronomi.

Vetëm **8%** të punësuar



3/4 nuk kërkojnë punë.

Dy intervenime që sugjeron studimi:

Kopshte



&


Transport publik



1. Punët në qytet do të ishin të qasshme.
2. Gratë do të kërkonin punë dhe do të punonin.
3. Bizneset do të përfitonin.
4. Migrimi do të ngadalësohej apo edhe të kemi kthim në fshatra.

Disa studime kanë shikuar llojet e punëve në ofertë. Siç ka gjetur [GAP](#), në KosovaJob prijnë punët si shitës dhe keshier, pasuar nga kamarier, kuzhinier, enëlarës dhe recepcionist, dhe më pastaj ne punë të ndryshme të zyrës me shkathtësi të ulët. Të gjitha këto vende të punës kanë disa tipare: (a) nuk paguhet shumë, (b) kërkojnë orar fleksibil, (c) mund të bëhen nga të gjithë, dhe (d) nuk kërkojnë arsim të lartë apo përvojë. Nga kategoritë me kërkesë më të lartë për punë si këto të listuara më lartë, mund të bëhen nga të rinjtë, gratë e deri diku madje edhe nga të moshuarit. Po të kishte transport të duhur dhe kopshte, me siguri se do të rritej kërkitimi për punë, që do të ulte edhe shkallën e joaktivitetit, edhe të papunësisë, pa pasur nevojë të nxisë migrimin por duke mundësuar secilën grua që punësohet që të kthehet në shtëpi pas punë.

Është lajm i mirë që tek moshat më të reja, përqindja e grave në treg të punës është më e lartë (deri në 60%). Deri tek mosha 35 vjeçare, gratë qëndrojnë më mirë se mesatarja e grave të të gjitha moshave (42%) siç shihet në grafikonin më lartë, ndërsa mbi moshën 35 vjeçare, përfshirja e tyre në treg të punës është mesatare. Më 2024, ka rënie të të fuqisë joaktive, por rënia është e ulët për shkak se ka rënie të popullatës në përgjithësi. Tek të rinjtë, vajzat në kategorinë NEET, d.t.th. që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollim apo trajnime janë pothuajse në të njëjtin nivel si djemtë, me 32% krahasuar me 31% të djemve. Studime të tjera mund të kërkojnë shkakun – nëse shkak është që ka ndryshim të mendësisë, atëherë është lajm i mirë, nëse shkak del se janë obligimet familjare, atëherë dëshmon se rekomandimet tona janë me të vërtetë të duhura.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).


Një studim ka hulumtuar perceptimet e bizneseve për rekrutimin e grave duke u brengosur se kanë obligime tjera familjare, nuk kanë përvojë, apo që ju mungojnë shkathtësitë. Gjithashtu, hulumtimet tregojnë që arsyet pse gratë nuk punojnë janë të shumta, por më shpesh se tek meshkujt janë arsyet familjare (28%), apo kujdesi për fëmijët apo të rritur me aftësi të kufizuar (3.9%) apo se nuk dëshiron punë me orar të plotë (9.8%). Gratë janë më tepër të përfaqësuara si përqindje tek kategoritë me orar të pjesshëm.

Transporti publik dhe kopshtet si parakusht për zhvillim të hovshëm të vendit

Kosovë	Burra	Gra	Gjithsej
Kujdesi për fëmijët apo të rriturit me aftësi të kufizuar	0.7%	3.9%	1.3%
Sëmundje ose i paaftë (invaliditet)	0.6%	0.4%	0.6%
Arsye të tjera personale ose familjare	13.2%	28.0%	16.1%
Vazhdon shkollën ose trajnimin	2.0%	2.3%	2.1%
Nuk ka mundësi të gjejë punë me orar të plotë	45.1%	31.5%	42.5%
Nuk dëshiron një punë me orar të plotë	5.8%	9.8%	6.6%
Arsye tjetër	32.5%	24.1%	30.9%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Hulumtimi që ka realizuar D4D me anketë omnibus ka shikuar edhe gatishmërinë për të punuar në bazë të moshës. Është lajm i mirë që mospërfshirja në treg të punës është dukuri e grave më të moshuara dhe të rejat janë duke kërkuar punë më tepër. Nëse ofrohen kushte, ka mundësi që të fitojmë një gjeneratë që t'a nxjerrim në treg të punës dhe mos të mbetet pa punë për kohë të gjatë dhe të dekurajohet dhe të heqë dorë nga kërkimi i punës më vonë.



Burimi: Të dhëna të mbledhura nga hulumtimi në terren gjatë muajit qershor 2025.

Për fat të keq, pikërisht personat me të ardhura sa më të ulëta kërkojnë punë më pak. Respondentët me të ardhura mbi 900 euro kanë kërkuar punë më së shumti (71%), përderisa ata pa të ardhura kanë kërkuar punë vetëm 52%. Në pyetjen pse nuk po kërkonin punë, 16-17% (19% për gratë) theksojnë se nuk kanë kujt t'ia lënë fëmijët. Një përqindje e ngjashme tek gratë, por dukshëm më e ulët tek burrat, është se nuk ka kush të kujdeset për të moshuarit në shtëpi. Për 2/3 e meshkujve, është pengesë mungesa e shkathtësive relevante, që është rasti vetëm për 1/3 e grave. Edhe kostoja e transportit është problem më i lartë për gratë, të cilat edhe kanë më pak vetura në posedim apo në dispozicion krahasuar me meshkujt.

Cila është arsyeja kryesore pse nuk po kërkonin punë?	Burra	Gra
Nuk kam kujt t'ia lë fëmijën/ët	12.5%	18.8%
Nuk ka kush të kujdeset për të moshuarit në shtëpi	4.2%	18.8%
Nuk ka vende pune që përputhen me aftësitë e mia apo mungesë e aftësive	66.7%	37.5%
Kostoja e transportit për në punë është e papërballueshme	4.2%	6.3%
Arsye tjetër	12.5%	18.8%

Burimi: Të dhëna të mbledhura nga hulumtimi në terren gjatë muajit qershor 2025.


Është interesante se në zona urbane, gati ¼ e respondentëve theksojnë se nuk kanë kujt t'ia lënë fëmijët, mbase se në fshatra ky obligim i lihet të moshuarve që jetojnë në të njëjtën shtëpi apo në afërsi. Kujdesi për të moshuarit është njësoj problem për 11% të respondentëve, mbase për faktin se as në qytete nuk ka kujdes ditor për ta. Kostoja e transportit është problem për 12% të banorëve në zona rurale dhe aspak problem për zonat urbane.

Transporti publik dhe kopshtet si parakusht për zhvillim të hovshëm të vendit

Cila është arsyeja kryesore pse nuk po kërkonti punë?	Urban	Rural
Nuk kam kujt t'ia lë fëmijën/ët	23.3%	8.0%
Nuk ka kush të kujdeset për të moshuarit në shtëpi	10.0%	12.0%
Nuk ka vende pune që përputhen me aftësitë e mia / mungesë aftësish	50.0%	56.0%
Kostoja e transportit për në punë është e papërballueshme		12.0%
Arsye tjetër	16.7%	12.0%

Burimi: Të dhëna të mbledhura nga hulumtimi në terren gjatë muajit qershor 2025.


Gratë në përgjithësi kërkojnë punë me orar të shkurtuar që është argument se është mirë të ketë transport publik më të shpeshtë dhe jo domosdo deri në vonë në mbrëmje.



Burimi: Të dhëna të mbledhura nga hulumtimi në terren gjatë muajit qershor 2025.

Siç është dëshmuar në përgjithësi edhe nga tri mikro-studimet nga tri fshatra në komuna të ndryshme, rreth 1/5 e kosovarëve

dërgojnë fëmijët në kopsht, dhe një përqindje e ngjashme del edhe nga regjistri i popullatës. Por përqindja nuk është e njëjtë gjithandej. Në qytet, 24% dërgojnë fëmijët në kopsht, përderisa në fshat vijnë vetëm 14%. Dallimi më i madh është në kopshte publike, të subvencionuara nga mjetet publike, ku vijimi në kopsht është dyfish më i lart në qytet.




Burimi: Të dhëna të mbledhura nga hulumtimi në terren gjatë muajit qershor 2025.

Fakti që ka pak kopshte edhe tregon për mospërfshirjen e grave në vendimmarrje, politika e dominuar nga burrat ka investuar më tepër në rrugë dhe më pak në trotuare, transport publik apo kopshte.

Në anketë është vërejtur një korrelacion i qartë mes të ardhurave dhe dërgimit të fëmijëve në institucion parashkollor. Qytetarët me të ardhura më të larta kanë tendencë më të lartë


të kenë fëmijët në kopsht, përderisa ata me të ardhura më të ulëta jo. Kjo madje vlen edhe për kopshtet publike, ku shumica kanë kriter që të dy prindërit të jenë të punësuar. Kjo politikë ka logjikën në atë se atyre prindërve u duhet ndihmë në përkuqdes të fëmijëve – që është absurde sepse ngujon gratë tjera në shtëpi të cilat do të punonin ose do të vijonin kurse për të marrë shkathtësi për nevoja të tregut. Në përgjithësi, ky trend përforcon pabarazinë në shoqëri, sepse vijimi në kopsht i jep një përparësi fëmijëve nga familje me të ardhura më të lartë.



Burimi: Të dhëna të mbledhura nga hulumtimi në terren gjatë muajit qershor 2025.

Zonat urbane kanë qasje më të mirë në **transport publik**. Në anketë, gati 2/3 e banorëve në zona urbane kanë raportuar se kanë linjtë të rregullt për transport publik, një përgjigje që kanë dhënë më pak se gjysma e atyre në zona rurale. Në fakt, banorët në zona rurale varen më tepër në transport sesa në ata në zona urbane. Siç është dëshmuar edhe nga mini-

studimet e tri fshatrave në këtë seri, vetëm fshatrat në rrugë kryesore kanë transport për qytet përderisa banorët në thellësi nuk kanë. Për më tepër, shpesh transporti kufizohet vetëm në orare të shkollave dhe vetëm në periudhat kur ka shkollë. Për një person që gjen punë me pagë të ulët, mungesa e transportit është pengesë sepse nuk ka levërdi të përdor veturë për çdo ditë.



Burimi: Të dhëna të mbledhura nga hulumtimi në terren gjatë muajit qershor 2025.

Rekomandime specifike dhe Plan veprimi

Për Qeverinë dhe Kuvendin, objektivi kryesor duhet të jetë Përfshirja e masave në agjendën kombëtare dhe buxhetin shtetëror. Rekomandohet që të hartohet një **Strategji Kombëtare për Kujdesin e Hershëm dhe Transportin Rural** e cila:

- ↪ shpall hapjen e çerdheve publike në zonat rurale si prioritet kombëtar, duke i integruar ato në rrjetin arsimor publik.
- ↪ dizajnon një skemë subvencionimi për transport publik rural, me fokus tek gratë dhe punëtorët me të ardhura të ulëta.
- ↪ alokon fonde të dedikuara për çerdhe dhe transport publik në buxhetin vjetor, duke i trajtuar si investime zhvillimore, jo vetëm sociale.
- ↪ krijon një mekanizëm monitorimi që mat efektet e këtyre masave në punësimin e grave, uljen e shpërnguljes dhe zhvillimin lokal.

Si cak për vitin 2026 mund të vendoset hapja e **20 çerdheve të reja në zona rurale** dhe për 2027 të vendoset si cak **të paktën 30% e fëmijëve ruralë (mosha 0–5)** të kenë qasje në çerdhe publike. Për **2028 të vendoset si cak** ulja me **10% të shpërnguljes nga zonat rurale** përmes rritjes së shërbimeve bazike.

Për **komunat dhe partitë që garojnë për zgjedhjet lokale, objektivi kryesor duhet të jetë** integrimi i

prioriteteve në programe zgjedhore dhe buxhete komunale si vijon:

- ↳ Të përfshijnë çerdhet dhe transportin publik si pikat kryesore të programeve zgjedhore, duke u zotuar publikisht para qytetarëve.
- ↳ Të hartojnë projekte konkrete për hapjen e çerdheve dhe subvencionimin e linjave të transportit, duke bashkëpunuar me sektorin privat dhe OJQ-të.
- ↳ Të sigurojnë që buxhetet komunale të reflektojnë prioritetet e grave dhe familjeve, jo vetëm investime në infrastrukturë tradicionale (rrugë, asfalt).
- ↳ Të zhvillojnë mekanizma konsultimi me gratë dhe grupet e interesit në komunitet, për të siguruar që këto shërbime adresojnë realisht nevojat lokale.

Inkurajojmë që më 2026, çdo komunë të ketë plan konkret për **hapjen e të paktën një çerdheje rurale dhe një linjë të subvencionuar transporti publik**, më 2027, 50% e komunave të arrijnë të krijojnë **partneritete publike-private** për menaxhimin e çerdheve ose linjave të transportit. Më **2028**, komunat të arrijnë që **min. 25% e grave të papuna në zonat rurale** të kenë qasje praktike në tregun e punës.

Lista e publikimeve

Interesi Publik

- #1 Sejdiu, Dardan dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. ['Taksa' e fshehur: pse kosovarët paguajnë më shumë?](#)
- #2 Gashi, Drilon and Shoghi Emerson. Maj 2013. [Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë](#)
- #3 Sutaj, Visar and Leon Malazogu. Janar 2013. [Le të ngrihet shoqëria civile e vërtetë: Roli i shoqatave me anëtarësi në formësimin e vendimmarrjes në shërbim të interesit publik](#)
- #4 Miftari, Naser. Shtator 2013. [Sfida e konsolidimit – Fuqizimi i pavarësisë së institucioneve të medias në Kosovë](#)
- #5 Ardiana Gashi dhe Artane Rizvanolli; Me kontribut nga Natalya Wallin, Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 25 shkurt 2015. [Sa kushton patriarkati?](#)
- #6 Rezarta Delibashzade, Laura Flemming, Ramadan Klisurica, Agon Maliqi dhe Rina Abazi. 11 Nëntor 2015 [Rëndësia e grupeve të interesit: Praktikat, rastet studimore dhe mësimet e nxjerra](#)
- #7 Dukagjin Pupovci dhe Gersi Gashi. Nëntor, 2015 [Reformimi i Universiteti të Prishtinës – mission i mundur?](#)
- #8 Leon Malzogu dhe Bernard Nikaj; Me kontribut nga Gulliver Brady. Nëntor, 2016. [Nxitje për llogaridhënie dhe performancë më të mirë në arsimin e lartë](#)
- #9 Jehona Serhati, me kontribut redaktues nga Abby Riley. Janar, 2017. [Stimujt për reformë: Rritja e mundësive për nxënësit/et dhe të diplomuarit/at e AAP-së në tregun e punës](#)
- #10 Isuf Zejna. Korrik 2017. [Zhvillimi i turizmit përmes politikave dhe legjislacionit efikas.](#)
- #11 Visar Sutaj. Tetor 2017. [Sa të pavarura janë autoritetet rregullatore në Kosovë?](#)

#12 Linda Abazi Morina dhe Rezarta Delibashzade. Me contribute nga Ajete Kërqeli dhe Valëza Zogiani. Nëntor 2017. [Joaktiviteti i grave në tregun e punës.](#)

#13 Ajete Kërqeli. Me kontribute nga Ardiana Gashi. Dhjetor 2017. [Ndryshimi i paradigmes – Barazi përmes lejes prindërore.](#)

#14 Vjollca Krasniqi. Mars 2018. [Gjendja e vullnetarizmit në Kosovë: Sfidat dhe perspektivat.](#)

#15 Xhavit Rexhaj. Me kontribut nga Rasim Alija. Prill 2018. [Funksionimi i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës: Analizë e punës dhe vendimeve.](#)

#16 Krenar Gashi dhe Gersi Gashi. Rishikuar nga Dr. Besnik Pula. Nëntor 2018. [Zanafilla plus dhjetë: Analizë e dekadës së pare të shtetësisë së Kosovës.](#)

#17 Aliriza Arenliu dhe Gersi Gashi, me contribute nga Elmedina Bajgora. Mars 2019. [Matja dhe vlerësimi i politikave të riintegrit: Politika të bazuara në dëshmi për të siguruar riintegrim të qëndrueshëm.](#)

#18 Alba Boshnjaku dhe David JJ Ryan. Qershor 2019. [Parental Rights in Kosovo: Legal analysis regarding the proposed amendments to maternity and parental leave \(vetëm në anglisht\).](#)

#19 Kaltrina Temaj. Rishikuar nga: Valëza Zogjani. Shtator 2019. [Inclusion of Women in decision-making and local governance in Kosovo](#) (vetëm në gjuhën angleze).

#20 Albert Krasniqi. Dhjetor 2020. [Analizë mbi veprimtarinë e Kuvendit të Kosovës në periudhën 2019-2020.](#)

#21 Judita Krasniqi. Janar 2021. [Kush e paguan çmimin më të lartë? Ndikimi i Covid-19 në punësimin e grave në Kosovë.](#)

#22 Instituti D4D. Tetor 2021. Komuna e Mitrovicës së Jugut: Reformë apo menaxhim më i mire i administrates lokale.

Këto punime dhe të tjera të publikuara nga instituti D4D, mund t'i lexoni në vegëzën: www.d4d-ks.org/punime

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndër-sektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: **www.d4d-ks.org**

